



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE MBESHTETESE
DHE INTEGRIMIT

NJOFTIM PËR VEND PUNE

Në vijim të shpalljes së procedurës “Levizje Paralele” AKEP shpall edhe procedurën e “Ngritjes në Detyrë”.

Vetem në rast se në fund të procedurës së levizjes paralele rezulton se ky pozicion është vakant dhe nuk është paraqitur asnjë kandidat , pozicioni është i vleshem nëpërmjet procedurës së “Ngritjes në Detyrë”.

NGRITJE NE DETYRE

Shpallje për ngritje në detyrë për plotësimin e vëndit të lirë të punës në AKEP, në pozicionin **“Përgjegjës i Sektorit të Autorizimeve”**.

Në zbatim të Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu V –“LËVIZJA PARALELE DHE NGRITJA NE DETYRE”, neni 26, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë, 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, Kreu VII, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) shpall :

a) Procedurën e ngritjes në detyrë, për pozicionin:

Përgjegjës i Sektorit të Autorizimeve në Drejtorinë e Autorizimeve, Frekuencave , Numeracionit dhe Autorizimeve.

b) Përshkrimi i përgjithshëm i punës (detyrat kryesore) për këtë pozicion janë:

1. Organizon punën në Sektor dhe kërkon nga specialistet zbatimin e detyrave të dhëna;
2. Në bashkëpunim me specialistin e sektorit përgatit dokumentacionin e plotë të aplikimeve për autorizim të përgjithshëm dhe autorizim individual për numeracion dhe ia paraqet Drejtorit të Drejtorisë për miratim;
3. Bën komente, jep rekomandime, kthen përgjigje dhe jep mendime për zgjidhje, për atë pjesë të korespondencës së AKEP që i delegohet;

4. Informon Drejtorin e Drejtorisë mbi subjektet që janë regjistruar në regjistër si dhe për caktimet, ndryshimet, revokimet dhe modifikimet e bëra në autorizimet e lëshuara nga AKEP;
5. Kontrollon përditësimin e të dhënave në Regjistrin e Autorizimeve të Përgjithshëm dhe Planin e Numeracionit të përgatitur nga specialistet e sektorit dhe e dërgon për publikim në faqen zyrtare të AKEP;
6. Merr pjesë në grupet e punës për hartimin e akteve rregullatore;
7. Përgatit planin mujor dhe raportin e analizës mujore të punës së Sektorit dhe kalimin e tij tek Drejtori i Drejtorisë;
8. Përgatit komentet, rekomandimet dhe shkresat për atë pjese të korespondences së AKEP që ka të bëjë me aktivitetin dhe detyrat që kryen;
9. Bën vlerësimin e punës së specialistit dhe i propozon Drejtorit projekte, trajnime dhe kualifikime me qëllim të njohjes me rekomandimet dhe direktivat e reja.

c) Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv.
4. Të plotësojë kushtet e tjera të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, për klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil.
5. Të përmbushë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kërkesat e veçanta për këtë vend pune janë :

- Niveli arsimor: Inxhinieri Elektronike ose Juridik
- Të ketë eksperiencë në fushen e teknologjisë së informacionit dhe minimumi 1 vit.
- Njohuri shumë të mira të gjuhës Angleze shoqëruar me dëshmi përkatëse.
- Njohuri shumë të mira praktike në përdorimin e kompjuterit dhe të programeve aplikative dhe aftesi për të perpunuar të dhëna teknike

- Të ketë eksperience punë në grup, aftësi gjykimi dhe hartimi të dokumentave të ndryshem që lidhen me aktivitetin e sektorit.
- Të aftësi për të organizuar punën vetjake dhe atë në grup, si dhe për të dhënë sugjerime dhe propozime për ecurin e punës.
- Certificate apo deshmi për kualifikime në shkollime/kurse sipas profilit/sektorit ku punon.
- Preferohet të ketë kryer Studimet Pasuniversitare Master apo ekuivalente me to.
- Aftësi shumë të mira për të relatuar me shkrim dhe me gojë në nivelet me të larta drejtuese.
- Njohuri dhe interes i vazhdueshem për të qënë i informuar vazhdimisht me vendimet e nxjerra nga Këshilli Ministrave, Presidenca dhe Kuvendi, Vendimet e Këshillit Drejtues si dhe me Urdherat e Udhezimet e ndryshme të cilat janë gjithnjë orientues në punë.
- Aftësi në komunikim me koleget e Institucionit eprorë, dhe me koleget në institucionet e tjera
- Aftësi për të punuar me ngarkese maksimale dhe afate të shkurtra.

ç) Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Protokollit të AKEP, dokumentet e dosjes së tij personale:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës, nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave, nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar. - Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
- Aktin e emërimit si nëpunës civil.
- Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që aplikanti nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Fotokopje të një vlerësimi vjetor.
- Fotokopje të librezës së punës.

- Certifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje të kartës së identitetit.

d) Pranimi i dokumentave do të bëhet deri në datën 14.11.2014.

dh) Rezultatet për verifikimin paraprak të kushteve minimale të procedurës lëvizje paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifike të vendit të punës do të dalin në datë **17.11.2014** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të AKEP.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse, brenda 3 ditëve pune nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 3 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

e) Testimi dhe Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e AKEP (salla e mbledhjeve) në datën **24.11.2014**, ora 10.00.

ë) Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi:

- Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Kodin e Proedurave Administrative;
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të tij;
- Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;
- Ligjin nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”;
- Ligjin nr.8517, date 22.07.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”
- Ligjin Nr. 9049, datë 10.04.2003 ”Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë” i ndryshuar
- Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 ” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar
- Ligjin Nr.8480, date 27.5.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike”
- Ligjin nr. 9918, datë 19.08.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

f) Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatet do të vlerësohen nga **Komisioni i Ngritjes në Detyre në AKEP**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar , testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. 20 pikë për dokumentacionin e dorëzuar (eksperiencë, trajnime, kualifikime të lidhura me fushën përkatëse (organizimi dhe zhvillimi i zgjedhjeve), si dhe 2 vlerësimet e fundit pozitive)
 - b. 40 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
 - c. 40 pikë për vlerësimin me shkrim.
- Kandidati fitues, është ai që renditet i pari nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70 % të pikëve). Në rastet e kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.143, datë, 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.
- g)** Lista e fituesve me mbi 70 pikë (mbi70%) do të shpallet në datën **25.11.2014**.
- h) gj) Njoftimi do të bëhet:** në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AKEP në datën **25.11.2014**.

Shpallja është e hapur për të gjithë nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.